



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:039151
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05737153

Pml.nr.284/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit A. M., për shkak të veprës penale “Vrasja”, nga neni 172 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, Nr.2023:039151, të datës 17.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.672/2023, të datës 06.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit A. M., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Nr.2023:039151, i datës 17.10.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.672/2023, të datës 06.02.2024, ashtu që kjo çështje penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, Nr.2023:039151, e datës 17.10.2023, i dënuari A. M., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “Vrasje”, nga neni 172 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-

së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzetedy (22) vjetëve, i cili dënim do të ekzekutohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.02.2023.

Është detyruar i dënuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguan paushallin gjyqësor në shumë prej njëqind (100) euro, ndërsa në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Familja e të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.672/2023, të datës 06.02.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Taulant Broqi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozimin që kërkesa të aprovet si e bazuar, ndërsa këto aktgjykime të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.159/2024, e datës 07.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. M., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit A. M., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë thekson se pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit nuk është bërë në harmoni me dispozitat përkatëse të procedurës penale, pasi që në aktakuzë thuhet se është përdorur shufra e hekurit, por nuk dihet nga kush dhe se gjykata e shkallës së parë është dashtë që të mos e miraton pranimin e fajësisë, pasi që gjatë gjykimit ka mundur të ndryshojë gjendja faktike. Po ashtu, edhe rrethanat janë mbivlerësuar, ngase rrethanat e parapara në veprat penale i janë marrë si rrethana rënduese, ndërsa rrethanat lehtësuese nuk janë vlerësuar e as nuk janë gjetur rrethana posaçërisht lehtësuese, siç janë: pranimi i fajësisë, pendimi i thellë dhe mos dashjen për të kryer veprën penale. Në këtë mënyrë, sipas mbrojtësit të të dënuarit, pranimi i fajësisë nuk është i plotë dhe konform dispozitave ligjore të KPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë konstatojë se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të bazuara.

Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1. lidhur me nenin 242, paragrafi 2 të KPP-së dhe një shkelje e tillë ka pasur ndikim në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e këtij aktgjykimi, ndërsa kjo shkelje nuk është evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Siç shihet edhe nga procesverbali i shqyrtimit fillestar, i datës 05.09.2023, të përpiluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në çështjen penale ndaj të pandehurve: A. M. dhe L. B. për shkak të veprës penale “Vrasje”, nga neni 172 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri A. M., edhe për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 paragrafi 1. të KPRK-së, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i dënuari A. M., kishte deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, ndërsa i pandehuri tjetër L. B., nuk e ka pranuar fajësinë, kurse gjykata e shkallës së parë e kishte miratuar pranimin e fajësisë për të pandehurin e parë, ndërsa e ka veçuar procedurën ndaj të pandehurit të dytë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se në këtë rast, gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore që i referohen kushteve për miratimin e pranimit të fajësisë, sipas nenit 241 të KPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit A. M., nuk është bërë në harmoni me dispozitat përkatëse të procedurës penale, siç me të drejtë thekson edhe mbrojtësi i tij në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke e pasur parasysh se i njëjti ishte akuzuar në bashkëkryerje me të pandehurin tjetër L. B., se e ka kryer veprën penale “Vrasja”, nga neni 172 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa ky i fundit nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale. Andaj, në një situatë të tillë dhe duke i pasur parasysh edhe specifikat konkrete të këtij rasti, ndërlidhjen e veprimeve kryerëse të të pandehurve dhe rrethanat tjera të rastit, gjykata e shkallës së parë është dashur që me një përkushtim maksimal profesional të vlerëson nëse në këtë rast janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë nga ana e tani të dënuarit A. M. Si rezultat i kësaj, arsyet e paraqitura në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me vlerësimin e pranimit të fajësisë, tani për tani, nuk gjejnë mbështetje në dispozitat e lartcekura ligjore, si dhe në shkresat e lëndës, në mënyrën se si janë përshkruar veprimet kryerëse në dispozitiv të aktakuzës, si dhe në deklaratimet e të dënuarit A. M., dhe të pandehurit L. B.

Siç shihet edhe nga përshkrimi i veprimeve kryerëse, i dënuari A. M., është shpallur fajtor për veprën penale të “vrasjes të kryer në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 31 të KPRK-së”, pavarësisht faktit se i pandehuri L. B., nuk e ka pranuar fajësinë për një vepër penale të tillë dhe ndaj tij është veçuar procedura penale. Në këtë mënyrë, për shkak të natyrës veprës penale dhe specifikatave të saj, si dhe nga ndërlidhja e veprimeve inkriminuese të të dy të pandehurve në këtë rast, siç është cekur edhe më lart, është dashur që me një përkushtim profesional maksimal, të shqyrton nëse në këtë rast janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga nenet 241-242 të KPP-së për miratimin e pranimit të fajësisë dhe neni 35 i KPP-së, për veçimin e procedurës penale.

Përveç kësaj, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rezulton se edhe rrethanat rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim ndaj të dënuarit A. M., janë vlerësuar në mënyrë të dyfishtë, ku për secilën veprë penale për të cilën është shpallur fajtor janë vlerësuar rrethanat, të cilat si të tilla është dashur që të vlerësohen vetëm një herë dhe po ashtu, është dashur që gjykata në fjalë të ketë në konsideratë edhe aspektin e mos trajtimit të elementeve të figurës së veprës penale si rrethana rënduese.

Gjithashtu, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është i mangët, edhe sa i përket veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që në këtë rast, nuk është arsyetuar mjaftueshëm, nëse “thika” me të cilën dyshohet se është kryer vepra penale e ka cilësinë e “armës së ftohtë” në kuptim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e cilat nuk janë evituar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin fillestar dhe t’i evitojë shkeljet e lartcekura, ndërsa më pastaj të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.284/2024, më datë 16.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi